



USAID | **KOSOVO**
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

KOSOVO MUNICIPAL INTEGRITY ACTIVITY

MANUALI PËR PËRDORUESIT E MOODLE

Versioni	1.0
Data	20.03.2024
Autori	Sedat Shehu
Rishikuar nga:	
Aprovuar nga:	IKAP

Based on the activity of the Memorandum of Understanding between DAI GLOBAL, LLC and KIPA

March 22, 2024

TABELA E PËRMBAJTJES

1. SHKURTESAT.....	3
2. HYRJA NË MOODLE.....	4
2.1. Çka është SMT-IKAP?.....	4
2.2. Pse të përdoret SMT-IKAP?.....	Error! Bookmark not defined.
2.3. Qasje në SMT-IKAP	4
3. NAVIGIMI NË NDËRFAQE TË SMT-IKAP.....	7
3.1. Shiriti i Navigimit	7
3.2. Paneli Kryesor	7
4. Përdorimi i përmbajtjes së kursit	9
4.1. Qasje në materiale të kursit:	9
4.2. Shikimi i mësimëve, temave, ose moduleve.....	10
5. BURIMET DHE AKTIVITET.....	11
5.1. Burime.....	11
5.1.1. Librat.....	11
5.1.2. Teksti	12
5.1.3. Skedarët	12
5.1.4. Lidhjet	13
5.1.5. Multimedia	13
5.1.6. Dosjet	14
5.2. Aktivitetet	16
5.2.1. Detyrat.....	16
5.2.2. Kuiz.....	17
5.2.3. Forumet	18
5.2.4. Wikit.....	19
5.2.5. Glosarët:.....	19
6. KOMUNIKIMI NË MOODLE:.....	19
6.1.1. Mesazhet	19
6.1.2. Njoftimet:.....	20
6.1.3. Kalendari	21
7. PROFILI I PËRDORUESIT	21

1. SHKURTESAT

IKAP	Instituti I Kosovës për Administratër Publike
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
AIS	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
DAI	Development Alternatives Incorporated
KMIA	Kosovo Municipality Integrity Activity
TI	Teknologjia e Informacionit
LMS	Learning Management System
Moodle	Modular Object-Oriented Dynamic Learning Environment
ILIAS	Integrated Learning, Information and Work Cooperation System
SMT	Sistemi i Menaxhimit të Trajnimeve

2. HYRJA NË MOODLE

2.1. Çka është SMT-IKAP?

SMT-IKAP është shkurtesë për Sistemin për Menaxhimin e Trajnimeve të Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP). Kjo platformë është një version i personalizuar dhe i dizajnuar i platformës Moodle, për të përmbushur nevojat specifike të menaxhimit të trajnimeve për IKAP-in.

2.2. Qasje në SMT-IKAP

Për të qasur në Sistemin për Menaxhimin e Trajnimeve, ndiqni këto hapa të mëposhtëm:

1. Hapni shfletuesin tuaj të internetit të preferuar dhe shkruani adresën **<https://smt-ikap.rks-gov.net>** në shiritin e adresës dhe shtypni **Enter**. (Shih figurën 1).




Figura 1.

Në shfletuesin tuaj të internetit do të shfaqet faqja e Sistemit për Menaxhimin e Trajnimeve, siç është paraqitur në figurën 2.




Figura 2.

2. Për të hyrë në Sistemin e Menaxhimit të Trajnimeve klikoni mbi lidhjen **Kyçu** (Shih figurën 3).




Figura 3.

3. Në faqen e kyçjes shkruani emrin e përdoruesit tuaj dhe fjalëkalimin dhe shtypeni butoni **Kyçu** për të hyrë në sistem. (Shih figurën 4.)




Figura 4.

Shënim: Emri i përdoruesit për nëpunësit civil është emri i llogarisë zyrtare të postës elektronike (për shembull: emri.mbiemri). (Shih figurën 5.)




Figura 5.

3. NAVIGIMI NË NDËRFAQE TË SMT-IKAP

3.1. Shiriti i Navigimit

Shiriti i navigimit gjendet në pjesën e sipërme të faqes dhe mundëson qasje të shpejtë në pjesë të ndryshme të SMT-IKAP. Shiriti i navigimit mbetet i qëndrueshëm në të gjitha faqet e SMT-IKAP, duke ju lejuar të kaloni shpejt midis kurseve, të qaseni në mesazhe tuaja dhe të shihni ngjarjet e ardhshme.

Në të janë lidhjet për Faqen kryesore, Panelin, Kurset e mia, Mesazhi, Profili i Përdoruesit dhe Edit mode.

3.2. Paneli Kryesor

Paneli kryesor është faqja fillestare në të cilën do të janë shfaqur: Lajmet e fundit, Ngjarjet e ardhshme, dhe Kurse në të cilat një pjesëmarrës është të regjistruar.

Nëse pjesëmarrësi është i regjistruar në kurse si "Higjiena e Sigurisë Kibernetike" dhe "Siguria e Fjalëkalimeve", ato do të shfaqen të listuara në panelin tuaj kryesor.

Në anën e djathtë të panelit janë të vendosura blloqet si: Përdoruesi i identifikuar, Skedarë private dhe Kalendari, etj. (Shih figurën 6.)

Mirë se vini përsëri, Nepunesi! 🙌

Lajmet e fundit

18 mar, 21:40
SMTADMIN IKAP
Trajnimi për Higjienën Kibernetike tani
përmes Sistemit për Menaxhimin e
Trajnimeve!
Temat më të vjetra ...

Ngjarje të ardhshme

Nuk ka ndonjë ngjarje të ardhshme
Shkoni në kalendar...

Pasqyrë e kursit

Të gjitha ▼

Kërko

Rradhit sipas emrit të kursit ▼

Kartë ▼



Higjiena e Sigurisë Kibernetike
Teknologji e Informacionit

0% i përfunduar



Siguria e fjalekalimeve
Teknologji e Informacionit

⋮

Përdorues i identifikuar

NC **Nepunesi Civil**

Adresa email:
nepunesi.civil@rks-gov.net

Skedarët privatë

 Detyra 1. MP-Fusheveprimi.pdf

[Menaxho fajllat privatë...](#)

Kalendar

← shkurt mars 2024 prill →

Hën	Mar	Mër	Enjt	Pre	Shtu	Die
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

Figura 6.

4. PËRDORIMI I PËRMBAJTJES SË KURSIT

4.1. Qasje në materiale të kursit:

Në shiritin e navigimit, klikoni mbi butonin "Kurset e mia". Dritarja "Kurset e mia" do të shfaqë të gjitha kurset në të cilat një përdorues është regjistruar. Nëse klikoni në njërin prej kurseve, për shembull në kursin "Higjiena e Sigurisë Kibernetike", do të shfaqet përmbajtja e këtij kursi. (Shih figurën 7.)




Figura 7.

Zakonisht, një kurs përmban njoftime, hyrje, objektiva dhe përmbajtjen e kursit e organizuar në module ose tema të caktuara.




Figura 8.

4.2. Shikimi i mësimëve, temave, ose moduleve

Klikoni mbi një temë ose modul për të hapur dhe shikuar përmbajtjen e saj. Në modulin 1 "Siguria Kibernetike", mund të shihni prezantimin e burimeve dhe aktiviteteve të këtij kursit.

Burimet janë module të Moodle që paraqesin materialet e kursit (librat, skedarët, dosjet, faqet, fushat tekstuale ose multimedial, dhe URL), ndërsa aktivitetet janë module të Moodle që mundësojnë interaktivitetin me përdoruesin (detyrat, mesazhet, reagimet, forume, kuizet, mësimet, etj.).




Figura 9.

5. BURIMET DHE AKTIVITETET

Në SMT-IKAP (Moodle), burimet dhe aktivitetet janë elemente themelore të përdorura për të strukturuar dhe përhapur përmbajtjen dhe ndërveprimet e kursit. Më poshtë janë përshkruar secili nga ta:

5.1. Burime

Burimet në SMT-IKAP (Moodle) janë materialet dhe informacionet që trajnerët vendosin në dispozicion të pjesëmarrësve për të ndihmuar në mësim dhe për të përmbushur qëllimet e kursit. Këto burime mund të përfshijnë tekst, dokumente, lidhje, audio dhe video, libra, prezentime, dhe shumë të tjera. Burimet sigurojnë materiale për lexim, studim, dhe përdorim nga pjesëmarrësit për të përshpejtuar mësimin dhe për të kuptuar temat e kursit.




Figura 10.

5.1.1. Librat

Burimi **libri** paraqet përmbajtje të strukturuar të mësimin në formatin e një libri brenda Moodle. Pjesëmarrësit mund të shfletojnë kapitujt dhe nënkapitujt për të pasur qasje në tekst, imazhe, multimedia dhe burime të tjera. Ato ofrojnë një paraqitje të përkushtuar të informacionit, duke e bërë më të lehtë për pjesëmarrësit të ndjekin materialeve të kursit. Gjithashtu pjesëmarrësit mund të printon përmbajtjen së kapitujve të librit.




Figura 11.

5.1.2. Teksti

Burimet e **tekstit** janë seksione brenda kursit ku trajnerët ofrojnë informacion tekstual drejtpërdrejt lidhur me materialet e kursit. Trajnuesit mund të gjejnë shënime leksionesh, udhëzime, përmbledhje, ose lloje të tjera të përmbajtjes tekstuale këtu. Është një burim i vlefshëm për të kuptuar koncepte kyçe ose për të ndjekur materialet e kursit.




Figura 12

5.1.3. Skedarët

Burimet e skedarëve janë vendet ku trajnerrët ngarkojnë materiale shtesë si dokumente, prezantime, PDF, imazhe, ose skedarë të tjerë dixhitalë. Pjesëmarrësit mund të kenë qasje në këto skedarë për të shqyrtuar lexime shtesë, shënime, ose burime multimediale që e plotësojnë materialet e kursit.




Figura 13.

5.1.4. Lidhjet

Burimi **lidhjet** përmbajnë hiperlidhje të ofruara nga trajnerët për faqe të internetit të jashtme ose faqe të tjera brenda SMT-IKAP (Moodle). Pjesëmarrësit mund të i ndjekin këto lidhje për të eksploruar burime të tjera, të kenë qasjen në artikuj të lidhur, ose për të gjetur informacion shtesë që përmirëson kuptimin për temat e kursit.




Figura 14.

5.1.5. Multimedia

Burimet **multimediale** përfshijnë përmbajtje audio, video, ose të tjera multimediale të ngulitura ose të lidhura brenda kursit. Pjesëmarrësit mund të hasin leksione të regjistruara, video instruktive, podcaste,

simulime interaktive, ose elemente multimediale të tjera që pasurojnë eksperiencën e tyre të mësimit dhe ofrojnë shpjegime vizuale ose auditive të koncepteve të kursit.



Figura 15

5.1.6. Dosjet

Burimi dosje janë dosje ose foldera të krijuara nga trajnerët për të organizuar dhe menaxhuar skedarë dhe burime të tjera brenda kursit. Pjesëmarrësit përfitojnë nga materialet e kursit të organizuara mirë, duke e bërë më të lehtë gjetjen dhe qasjes në burimet që i nevojiten për rrugën e tyre të mësimit.




Figura 16

Secili lloj burimi shërben si një mjet i vlefshëm për trajnuesit për të angazhuar me përmbajtjen e kursit, për të pasur qasje në materiale shtesë, dhe për të përmirësuar kuptimin e tyre për koncepte kyçe brenda SMT-IKAP (Moodle).

5.2. Aktivitetet

Në SMT-IKAP (Moodle) aktivitetet janë elementet të rëndësishme që i mundësojnë trajnerëve të angazhojnë pjesëmarrësit për të ndonjë aktivitet, ku mund të demonstrojnë njohuritë e tyre në kontekst praktik. Këto mund të përfshijnë detyra, diskutime, kuize, projekte, sondazhe, dhe të tjera. Aktivitetet inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të të pjesëmarrësve, ndihmojnë në zhvillimin e aftësive praktike dhe kritike, dhe ndihmojnë në vlerësimin e përparimit të pjesëmarrësve kurs.



5.2.1. Detyrat



Assignment

Aktiviteti **detyrat** përdoret nga trajnerët për të i dhënë pjesëmarrësve një detyrë për të kryer dhe për ta ngarkuar në sistem gjithnjë sipas udhëzimeve të trajnerit. Për shembull, nëse duhet të dorëzoni një punim hulumtues, klikoni në lidhjen e detyrës, ngarkoni dokumentin tuaj dhe klikoni "Dorëzo".



Figura 17

5.2.2. Kuiz



Quiz

Aktiviteti **kuiz apo testi** përdoret nga trajneri testet për të vlerësuar njohurit e pjesëmarrësve për materialin e kursit. Për shembull, nëse ka një kuiz apo test në fund të modulit apo në fund të kursit, klikoni në lidhjen e kuiz, lexoni çdo pyetje me kujdes, zgjidhni përgjigjet tuaja dhe dorëzoni kuizin kur të mbaroni.

Kushtojini vëmendje kufizimeve kohore dhe formateve të pyetjeve. Nëse testi ka një kufi kohor prej 60 minutash dhe përfshin pyetje të shumë zgjedhura dhe pyetje të shkurtër-përgjigje, menaxhoni kohën tuaj në mënyrë të përshtatshme dhe përgjigjuni secilës pyetje në mënyrë adekuate.




Figura 18




Figura 19

5.2.3. Forumet



Forum

Aktiviteti forumet, iu shërbejnë edhe trajnerit edhe pjesëmarrësve për të iniciuar temat për diskutime duke postuar përgjigje në temat e forumit. Për shembull, nëse ka një diskutim forumi për klasifikimin klasik, klikoni në lidhjen e forumit, lexoni pyetjen dhe postoni përgjigjen tuaj duke klikuar "Përgjigju".

Ndani mendimet dhe respektoni mendimet e të tjerëve. Mbani një ton respekti, qëndroni në temë dhe angazhohuni në dialogun me pjesëmarrësit të tjerë.



5.2.4. Wikit



Wiki

Aktiviteti Wiki është një mjet i integruar në platformën SMT-IKAP (Moodle) që mundëson bashkëpunimin në krijimin dhe redaktimin e faqeve wiki. Përdorimi i wikis mund të jetë i dobishëm për pjesëmarrësit për të inkurajuar bashkëpunimin dhe ndarjen e njohurive në një grup të caktuar. Për shembull, nëse një projekt wiki është krijuar për administratën publike, trajneri mund të inkurajojë pjesëmarrësit të klikojnë në lidhjen e wiki-s për të kontribuar me informacion mbi një temë të caktuar që ata kanë kërkuar. Ata gjithashtu mund të redaktojnë përmbajtjen ekzistuese sipas nevojës.

5.2.5. Glosarët:



Glossary

Kuptimi dhe roli i një "Glosari Aktiviteti" brenda SMT-IKAP (Moodle) është të shërbejë si një burim dinamik për pjesëmarrësit për të kuptuar dhe përdorur terminologjinë dhe konceptet e kursit. Përmes kontributit të tyre aktive, përsëritjes së hyrjeve, dhe pjesëmarrjes në diskutime, pjesëmarrësit mund të thellojnë kuptimin e tyre dhe të ndihmojnë në kultivimin e një mjedisi bashkëpunues të mësimi. Glosari gjithashtu ofron një mjet të përshtatshëm referimi për studimin dhe përsëritjen e akronimeve dhe terminologjisë, duke përmirësuar përvojën mësimore për përdoruesit e SMT-IKAP (Moodle).

6. KOMUNIKIMI NË MOODLE:

Komunikimi në SMT-IKAP (Moodle) siguron një mënyrë të shpejtë dhe efektive për të ndërvepruar me trajnerët dhe pjesëmarrësit e tjerë në platformë. Veglat me te përdorura janë **mesazhet** dhe **njoftimet**.

6.1.1. Mesazhet



Vegla mesazhet shfaq çdo mesazh të ri që keni marrë. Për të parë një mesazh, klikoni ikonën e zarfeve pranë emrit të dërguesit. Kjo do të hapë një dritare bisede, duke ju lejuar të lexoni dhe të përgjigjeni në mesazh. Nëse një mesazh ju dërgohet kur nuk jeni të kyçur në Moodle, atëherë mesazhi do të dërgohet si email në llogarinë e postës elektronike.





Figura 20

Përdorni funksionin e mesazheve për të komunikuar privat me përdoruesit e tjerë të Moodle. Për shembull, nëse keni një pyetje në lidhje me një detyrë, klikoni në ikonën e mesazheve, zgjidhni pranuesin, shkruani mesazhin tuaj, dhe klikoni "Dërgo".

Mbani diskutimet relevante për çështjet lidhur me kursin. Përdorni mesazhet kryesisht për pyetje rreth trajnimeve, bashkëpunim në projekte grupore, ose komunikim me trajnerin për çështje lidhur me kursin.

6.1.2. Njoftimet:


Njoftimet në SMT-İKAP (Moodle) janë përditësime të shkurtra nga trajnerët për informacione të rëndësishme të kursit. Pjesëmarrësit duhet të kontrollojnë rregullisht këto njoftime për të qëndruar të informuar për afate, ngjarje dhe detaje të tjera të kursit. Duke mbajtur shënim të njoftimeve, pjesëmarrësit mund të menaxhojnë efektivisht punën e tyre dhe të mbetën të angazhuar në procesin e mësimi.




6.1.3. Kalendari

Kalendari në SMT-IKAP (Moodle) është një mjet i rëndësishëm për pjesëmarrësit për të menaxhuar afatet e rëndësishme dhe ngjarjet e tyre në kurs.

Përmes kalendari, pjesëmarrësit mund të shikojnë datat e afateve të dorëzimit të detyrave, datat e provimeve, datat e ngjarjeve të kursit, dhe të tjera aktivitete të rëndësishme të planifikuara. Gjithashtu mund të shikojnë këto informacione në një format të lehtë për të u kuptuar, duke përdorur shfaqjen e ditës, javës, ose muajit në kalendari.



7. PROFILI I PËRDORUESIT



Profili i përdoruesit është i qasshëm nga çdo faqe dhe duke klikuar shigjetën pranë emrit tuaj (djathtas), ofron lidhje të dobishme.

Pas klikimit të shigjetës hapet menyja me submenutë si:


Profili: Në këtë seksion, përdoruesit mund të qaset informacionin personal dhe të përshtatin profilet e tyre. Kjo përfshin shtimin e përshkrimit personal, ngarkimin e fotos, dhe ndryshimin e parametrave të privatësisë.

Notat: Këtu pjesëmarrësit mund të shikojnë notat e tyre për detyrat e kursit dhe kuizet.

Kalendari: Në kalendar siç u përshkrua edhe më lartë, përdoruesit mund të shikojnë datat e rëndësishme të kursit, si afatet e dorëzimit të detyrave dhe ngjarjet e planifikuara. Kalendar siguron një mjet të dobishëm për organizimin e kohës së tyre.

Skedarët Privatë: Ky seksion lejon pjesëmarrësit të ngarkojnë dhe të ndajnë skedarë të tyre të rëndësishëm në Moodle për përdorim personal ose të ndarë me instruktorët dhe kolegët e kursit.

Fajllat privatë



Raportet: Në këtë seksion, përdoruesit mund të shohin raportet e tyre të kursit, duke përfshirë përfshirjen në aktivitete, performancën në detyra, dhe më shumë.

Preferencat: Këtu pjesëmarrësit mund të ndryshojnë parametrat dhe preferencat e tyre për përvojën e tyre në Moodle, duke përfshirë zgjedhjen e temës, të drejtat e qasjes, dhe shfaqjen e të dhënave.

Preferencat

Llogaria e përdoruesit

- Ndrysho profilin
- Ndrysho fjalëkalimin
- Gjuha e preferuar
- Preferencat e forumit
- Preferencat e redaktorit
- Preferencat e kalendarit
- Preferencat e bankës së përmbajtjes
- Preferencat e mesazheve
- Preferencat e njoftimit

Gjuhët: Në këtë pjesë, pjesëmarrësi mund të zgjedhin gjuhën e tyre të preferuar për përvojën e tyre në Moodle. Kjo lejon përdoruesit të shfletojnë dhe të kuptojnë përmbajtjen e kursit në gjuhën e tyre të preferuar. SMT-IKAP (Moodle) është në dispozicion në tri gjuhë: Shqip, Anglisht dhe Serbisht.



← Përzgjedhës i gjuhës

- English
- ✓ Shqip
- Serbian